

VENDIM
Nr.131, datë 21.1.2009

PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE TË KRITEREVE PËR PËRFITIMIN, NË FORMË GRANTI, TË ASISTENCËS FINANCIARE PËR ZONAT E THELLA MALORE DHE ME POPULLSI TË RRALLË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 26 të ligjit nr.9734, datë 14.5.2007 “Për turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfitojnë asistencë financiare, në formë granti, ata individë, persona fizikë a juridikë, që kërkojnë të zhvillojnë sipërmarrje turistike në zonat e thella malore dhe me popullsi të rrallë, për përmirësimin e strukturës ekzistuese.

2. Asistenca financiare jepet nga Fondi Kombëtar i Zhvillimit të Turizmit, nëpërmjet programeve të asistencës, për të mbështetur financiarisht projektet turistike, për përmirësimin e strukturave ekzistuese turistike në zonat e thella malore, me kusht që të sigurojnë:

- planimetrinë e strukturës ekzistuese;
- planimetrinë e strukturës, që do të përmirësohet;
- deklaratën për mosndryshimin e destinacionit të veprimtarisë së strukturës, që do të përmirësohet, deri në pesë vjet;
- deklaratën bankare, se subjekti mbështet pjesën tjetër, që nuk mbulohet nga programi i asistencës financiare;
- dokumentin e organit tatimor, i cili vërteton regjistrimin e përfituesit në këtë organ;
- deklaratën për hapjen, të paktën, e një vendi të ri pune.

3. Masa e mbështetjes me programe të asistencës financiare për këto projekte turistike varet nga rëndësia e investimit dhe hapja e vendeve të punës. Në zonat e thella malore dhe me popullsi të rrallë programet e asistencës financiare mund të mbulojnë deri në 50 për qind të kostove të pranueshme të investimit ose të hapjes së vendeve të reja të punës. Vlera maksimale financiare e asistencës nuk duhet të kalojë masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë.

4. Subjektet, që kërkojnë të përfitojnë një program asistence, aplikojnë pranë Agjencisë Kombëtare të Turizmit (AKT), e cila, pasi mbikëqyr përmbushjen e kushteve dhe të kriterëve, i paraqet, për miratim, komisionit ndërministror listën me emrat e subjekteve.

AKT-ja për aplikimet e miratuara, përgatit programet e asistencës, të cilat ia paraqet për miratim Komisionit të Ndhmës Shtetërore, në bazë të dispozitave të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”.

Komisioni ndërministror përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, përfaqësues të Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

5. Mënyra e funksionimit dhe e organizimit të komisionit ndërministror përcaktohet me urdhër të kryeministrit.

6. Pas miratimit të dhënies së programit të asistencës, drejtori i AKT-së nënshkruan kontratën/marrëveshjen përkatëse me subjektet, në përputhje me vlerën financiare të programit të asistencës.

7. Në rast se subjekti përfitues i asistencës financiare nuk plotëson detyrimet, sipas programit të miratuar, asistenca financiare quhet e keqpërdorur dhe ndaj subjektit veprohet në përputhje me nenin 27 të ligjit nr.9734, datë 14.5.2007 “Për turizmin”, të ndryshuar, dhe me dispozitat e kreut III, të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”.

8. Për dhënien e raportimin e çdo skeme të asistencës financiare dhe të çdo ndihme individuale, në bazë të këtij vendimi, ndiqen të gjitha rregullat dhe procedurat e përcaktuara në ligjin nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, dhe në aktet nënligjore, dalë në zbatim të tij.

9. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Agjencia Kombëtare e Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha